

Formular për SYLLABUS të lëndës

Të dhëna bazë për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë: Departamenti i gjuhës dhe i letërsisë gjermane
Titulli i lëndës:	Teoria e letërsisë
Niveli:	Bachelor
Statusi i lëndës:	E detyrueshme
Viti i studimeve:	Viti I, semestri II
Numri i orëve në javë:	2 + 0
Vlera në kredi - ECTS:	5
Koha dhe vendi:	L.: e mërkurë:17.30-19.30/ e premte 08:30-10:00
Mësimdhë-nësi i lëndës:	Prof. Ass. Dr. phil. NaimKryeziu
Detajet kontaktuese:	naimkryeziu@bluewin.ch
Përshkrimi i lëndës:	
	Lënda “Teoria e letërsisë” është disiplina që merret me studimin e letërsisë si dukuri kulturore, me përkufizimin e konceptit të saj dhe me shpjegimin e metodologjive e të teknikave të leximit, të interpretimit e të analizës së teksteve letrare. Nëpermjet kursit të teorisë së letërsisë studenti përfiton njohuri themelore për disa koncepte të përgjithshme, për funksionimin e instituteve letrare, për lidhjen midis tekstit e kontekstit dhe përe ecuritë e komunikimit letrar.
Qëllimet e lëndës:	
	Lënda “Teoria e letërsisë” synon që studenti: <ul style="list-style-type: none"> • të njihet me konceptet dhe me metodologjitë kryesore praktike për analizën e tekstit • të njohë ç’janë letërsia dhe teoria e letërsisë • të njohë ç’janë orientimet letrare • t’i shpjegohen roli dhe rëndësia e shoqërisë në krijimtarinë letrare • të njihet me llojet e romaneve dhe me gjinitë letrare • t’i shtjellohen pikëtakimet e teorisë së letërsisë si shkencë me shkencat e tjera • të mësojë se ç’janë tema e një vepre letrare, motivi, eufonia, ritmi, metri, fibula, etj.

	<ul style="list-style-type: none"> • Të fitojë një bazë të mirëfilltë të njohurive për studime shkencore në fushën e letërsisë.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<p>Pas mbarimit të kursit, studenti duhet të ketë njohuri të mjaftueshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • për metodologjitë themelore të teorisë së letërsisë • për objektin kryesor të teorisë së letërsisë • për dallimin midis letërsisë dhe teorisë së letërsisë • për letërsinë dhe për gjuhën letrare; • për letërsinë dhe për rolin e shoqërisë • për letërsinë si art • për lidhjet e letërsisë me artet e tjera • për qëllimet dhe për detyrat e studimeve letrare • për shkencat e letërsisë • për studimin e letërsisë si art gjuhësor • për analizën e veprës letrare • për strukturën e veprës letrare • për eufoninë, ritmin dhe metrin • për narratorin në një vepër letrare • për temën, motivin dhe fabulën në veprën letrare • për gjinitë letrare • për epin, poezinë lirike, poemën, sonetin, romancën, baladën, nekrologjinë, esenë, romanin, dramën, poezinë dramatike, metaforën, komedinë, novelën, ironinë, etj.

Kontributi në ngarkesën e studentit (kjo duhet të përkojë me rezultatet e përvetësimit nga ana e studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	22.5
Ushtrime teorike/laboratorike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	10 min	15	2.5
Kollokfiime,seminare	5	2	10
Detyra të shtëpisë	2	15	30
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	15	45
Përgaditja përfundimtare për provim	10	1	10

Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	1	2	2
Projektet,prezentimet ,etj	30 min	1	0.5
Totali			122.5:25 = 4.9 5 ECTS
Metodologjia e mësimdhënies:	Mësimi zhvillohet me ligjërata dhe me shpjegime përkatëse. Gjatë shpjegimeve zbatohet metoda ndërvepruese. Në fillim të ligjërates zhvillohet gjithmonë debat për leksionin e mëparshëm. Në fund të ligjërates bëhet një përsëritje e përbashkët e leksionit pasues.		
Metodat e vlerësimit:	<ul style="list-style-type: none"> • Testi i parë 15 % • Testi i dytë 15 % • Pjesëmarja aktive në ligjërata 15% • Vijimi i rregullt në mësim 5 % • Provimi përfundimtar (me shkrim/me gojë) 50% 		
Literatura			
Literatura bazë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. René Wellek dhe Austin Warren: <i>Teoria e letërsisë, Tiranë 2007</i> 2. Milivoje Solar, <i>Hyrje në shkencën për leterësinë, Tiranë 2004</i> 3. Zejnullah Rrahmani, <i>Teoria e letërsisë, Prishtinë 2008</i> 		
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Metzler Verlag Stuttgart: <i>Einführung in die Literaturtheorie, Stuttgart, 2012</i> 		
Plani i detajuar i mësimit			
Java	Ligjërata që do të zhvillohet		
<i>Java e parë</i>	Teoria e letërsisë: -Me se merret teoria e letërsisë -Pikëtakimet e shkrimeve letrare me shkrimet tjera -Shkencat e studimit të letërsisë (degët) -Objekti i studimit të degëve të shkencës së letërsisë -Zanafilla e teorisë së letërsisë -Zhvillimi i teorisë së letërsisë		
<i>Java e dytë</i>	Letërsia dhe studimi i letërsisë: -Dallimi midis letërsisë dhe studimit të letërsisë		

	<ul style="list-style-type: none"> -Letërsia gojore -A mund të quhet letërsi gjithçka që është shkruar -Veprat artistike -Funksioni i letërsisë.
<i>Java e tretë</i>	<p>Letërsia dhe gjuha:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Rëndësia e gjuhës në letërsi -Raporti i letërsisë ndaj realitetit shoqëror -Të kuptuarit e gjuhës në veprën letrare.
<i>Java e katërt</i>	<p>Letërsia dhe shoqëria:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Letërsia dhe gjuha -Veprat letrare -Raportet e ndërlikuara të shoqërisë dhe të letërsisë -Si duhet të shqyrtohen veprat letrare -Pasqyrimi i ngjarjeve shoqërore në një roman -Ndikimi i veprave letrare në shoqëri.
<i>Java e pestë</i>	<p>Letërsia si art:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Veçoritë e artistike të letërsisë dhe nevoja që letërsia të kuptohet e të studiohet në radhë të parë si art -Shfaqja e një vepre letrare -Poetika e Aristotelit.
<i>Java e gjashtë</i>	<p>Letërsia dhe artet e tjera:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Marrëdhëniet e letërsisë me artet figurative dhe muzikore -Ndikimet dhe frymëzimet e ndërsjella të arteve të ndryshme -Bashkëpunimi i ndërsjellë i arteve.
<i>Java e shtatë</i>	<p>Qëllimet dhe detyrat e studimit të letërsisë:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Letërsia si veprimtari krijuese gjuhësore -Kush merret me letërsi -Kontradiktat midis qëndrimit teorik dhe praktik ndaj letërsisë -Çfarë duhet të nxisë studimi i letërsisë.
<i>Java e tetë</i>	<p>Shkenca për studimin e letërsisë:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Ndarja e shkencës së letërsisë -Historia e letërsisë -Teoria e letërsisë -Kritika letrare.
<i>Java e nëntë</i>	<p>Studimi shkencor i letërsisë si art gjuhësor:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Estetika -Linguistika.
<i>Java e dhjetë</i>	<p>Analiza e veprës letrare:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Të kuptuarit e një vepre letrare

	<ul style="list-style-type: none"> -Analiza gjuhësore e tekstit -Analiza teoriko-letrare e një vepre artistike.
<i>Java e njëmbëdhjetë</i>	<p>Struktura e veprës letrare:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Ndërtimi i veprës letrare -Teoria e strukturës të shtresave të veprës letrare -Shtresa e tingullit -Shtresa e njësisë së kuptimore -Shtresa e botës së veprës -Analiza e veprës letrare si unitet.
<i>Java e dymbëdhjetë</i>	<p>Eufonia, ritmi dhe metri:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Eufonia në një vepër letrare -Cilësitë e qenësore të brendshme dhe cilësitë relative të tingullit -Intonacioni -Kakofonia -Rima -Metri.
<i>Java e trembëdhjetë</i>	<p>Tema, motivi dhe fabula:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Tema si kuptim i tërësor i veprës -Motivi - Fabula në veprën letrare.
<i>Java e katërbëdhjetë</i>	<p>Narratori, karakteri dhe ideja:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Ç'nënkuptojmë me narratorin në veprën letrare -Roli i narratorit në veprën letrare -Analiza e karakterit -Ideja në analizën e veprës letrare.
<i>Java e pesëmbëdhjetë</i>	<p>Gjinitë letrare:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Epika -Lirika -Dramaturgjia.

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes

Studentët duhet të vijnë me kohë në auditor, sepse ardhja me vonësë sjell ndërprerjen e mësimit dhe pengon, çrregullon e shpërqendron vëmendjen e studentëve. Gjatë orës së mësimit nuk lejohet përdorimi i mjeteve elektronike, sepse shkaktojnë zhurmë ose pengesa të tjera.

Hartoi: Prof. Ass. Dr. Naim Kryeziu (Mars 2014)